



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJII DHE TRASHËGIMI KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi: Arkeologji dhe trashëgimi kulturore

LËNDA: BAZAT E EPIGRAFISË

Pedagogu: Prof. Dr. Faik DRINI
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/semestri: II/II

EKSTRAKT:

Lënda u ofron studentëve njohuri bazë për fushat e epigrafisë greke dhe latine në përgjithësi dhe për studimet e bëra në këto fusha, të cilat hedhin dritë mbi historinë e lashtë të Shqipërisë, në veçanti. Për vetë natyrën dhe tematikën e dokumenteve mbishkrimore të zbuluara në qendrat antike të vendit tonë, studimi i tyre sjell një ndihmesë të çmuar për trajtimin e shumë aspekteve të kësaj historie, që lidhen me zhvillimin ekonomik, social, politik, juridik dhe religjioz. Këto aspekte ndriçohen nëpërmjet kategorive të ndryshme të mbishkrimeve, sikurse janë mbishkrimet funerare, mbishkrimet votive apo religjioze, aktet e lirimit të skllëvërve, mbishkrimet honorifike ose dekretet e nderit për qytetarët e huaj, mbishkrimet agonistike për lojrat sportive dhe festat antike, mbishkrimet rrugore dhe ato të ndërtimeve, etj. Përparësia e të dhënave të dokumenteve epigrafike në krahasim me të dhënat e burimeve të tjera, qëndron në faktin se ato janë autentike, sepse na vijnë sot ashtu siç kanë qenë shkruar në antikitet, pas pësuar ndërhyrje nga duar të dyta apo të treta, sikurse ndodh shpesh, përshembull, me burimet letrare të autorëve antikë.

TEMAT:

LEKSION 1. Objekti i studimit të epigrafisë dhe ndihmesa e saj për studimin e historisë së lashtë.

LEKSION 2. Përhapja gjeografike e mbishkrimeve greke dhe latine në Shqipëri dhe kronologjia e tyre.

LEKSION 3. Përpunimi dhe paraqitja e një dokumenti epigrafik: kriteret dhe teknikat.

LEKSION 4. Gjuha dhe stili i mbishkrimeve si dhe karakteri i gërmave të tyre si elemente datimi.

LEKSION 5. Mbishkrimet greke, kategoritë dhe të dhënat e tyre – Mbishkrimet funerare.

LEKSION 6. Mbishkrimet votive kushtuar Asklepit dhe Dioskurëve.

LEKSION 7. Aktet e lirimit të skllëvërve – Butrint.

LEKSION 8. Mbishkrimet honorifike ose dekretet e nderit për qytetarët e huaj – proksenia.

LEKSION 9. Mbishkrimet agonistike për lojrat sportive dhe festat antike.

LEKSION 10. “Memoriae damnation” në mbishkrimet

LEKSION 11. Mbishkrimet latine, kategoritë dhe të dhënat e tyre – Mbishkrimet funerare.

LEKSION 12. Mbishkrimet votive kushtuar Eskulapit etj.

LEKSION 13. Mbishkrimet rrugore, gurët miliarë.

LEKSION 14. Mbishkrimet e ndërtimeve, të tempujve dhe të fortifikimeve.

LEKSION 15. Raste të veçanta : Mbishkrimi dygjuhësh i Amanties

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

Epigrafi greke

1. L. Robert, *Épigraphie. L'histoire et ses méthodes*, Encyclopédie de la pléiade, Paris, 1961

2.. M.Guarducci, *L'epigrafia greca dalle origini al tardo impero*, Roma, 1987

3. F. Berard, D. Feissel, P. Petit Mengin, M. Sève, *Guide de l'épigraphiste*, Presse de l'École Normale Supérieure, Paris, 1989
4. P. Cabanes, F. Drini, *Corpus des inscriptions grecques d'Illyrie méridionale et d'Épire*, DE BOCCARD, Vol. 1-2, Paris, 1995; vol. 3, Paris, 2007; vol. 4, Paris, 2016

Epigrafi latine

1. R. Bloch, *L'épigraphie latine*, Presse Universitaire de France, Paris, 1952
2. R. Cagnat, *Cours d'épigraphie latine*, Paris, 1914; Roma, 1966
3. J.-M Lassère, *Manuel d'épigraphie romaine*, I-II, Paris, 2005
4. S. Panciera, *Epigrafi, epigrafia, epigrafisti*, I-III, Roma, 2003